



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 304/1 prot.

Tiranë, më 19.02.2019

VENDIM
Nr.11, datë 19.02.2019

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT
TË ZBATIMIT TË VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 39, DATË 27.04.2018, NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË PATOS

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 39, datë 27.04.2018, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Patos dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”,

KONSTATOVA SE:

Bazuar në Urdhrin nr. 75 (749 prot.), datë 03/10/2018, “Për fillimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, pas përfundimit të afatit të vendosur për rregullimin e ligjshmërisë”, Komisioneri ka nisur procesin e mbikëqyrjes në vazhdim, që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimit paralajmërues nr. 39, datë 27.04.2018, pas përfundimit të afatit të caktuar nga Komisioneri për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Patos.

Ky proces u realizua nëpërmjet verifikimit të situatës në institucion, në përfundim të të cilit grupi i punës përpiloi edhe një Akt – Konstatimi, nga përmbajtja e të cilit vërej se:

Në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 2, datë 13.01.2017, nëpërmjet Vendimit nr. 213, datë 25.10.2017, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Patos”, Komisioneri ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Patos.

Pas përfundimit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka dërguar pranë Bashkisë Patos raportin përfundimtar dhe vendimin paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë me nr. 39, datë 27.04.2018, duke i lënë institucionit detyra për përmirësimin e situatës si dhe një afat prej 60 ditësh për zbatimin e tyre.

Mbështetur në gjetjet e specifikuar në këtë raport, si dhe në detyrat e lëna për Bashkinë Patos, në përmbajtjen e vendimit paralajmërues për rregullimin e ligjshmërisë, si dhe duke verifikuar në subjekt veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, **konstatoj** situata aktuale e administrimit të shërbimit civil, e specifikuar sipas radhës së detyrave në vendim, rezulton si më poshtë:

Në vendimin paralajmërues të Komisionerit konkretisht në *pikën 2 të tij*, është lënë detyrë që të konstatohet pavlefshmëria absolute për **18** rastet e emërimit të përkohshëm nga ana e Kryetarit të Bashkisë, si dhe njësia përgjegjëse të hartojë dhe zbatojë planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil. Në 4 raste, institucioni ka vendosur lirim të punonjësve. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. ***** , Përgjegjëse Sektori, Drejtoria e Hartimit dhe Aplikimit të Projekteve (emëruar me aktin nr. 2230/2, datë 30.12.2016), liruuar me aktin nr. 526/3 prot., datë 07.03.2018.
2. ***** , Specialiste e Aplikimit dhe Menaxhimit të Projekteve (emëruar me aktin nr. 1532/2, datë 31.12.2015), liruuar me aktin nr. 511/1 prot., datë 01.03.2018.
3. ***** , Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Politikave dhe Monitorimit të Shërbimeve (emëruar me aktin nr. 63, datë 08.01.2016), liruuar me aktin nr. 1611/2 prot., datë 16.07.2018.
4. ***** , Specialiste në Drejtorinë e Legjislacionit dhe Konsultimit me Publikun (emëruar me aktin nr. 483, datë 08.03.2017), liruuar me aktin nr.596/1 prot., datë 16.03.2018.

Me aktin nr. 338 prot., datë 09.02.2018, njësia përgjegjëse ka miratuar planin vjetor dhe ka parashikuar të gjitha pozicionet pjesë e shërbimit civil, si dhe ka zhvilluar procedurën e konkurrimit për pozicionet e mëposhtme, në përfundim të së cilës rezulton se:

1. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialiste e Shërbimit të Barazisë dhe Kundra Dhunës*”, emëruar me aktin nr. 2206/3 prot., datë 29.12.2017.
2. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialiste e Taksave dhe Tarifave të Familjeve*”, emëruar me aktin nr. 623/3, datë 11.04.2018.
3. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialiste Shërbimesh*”, emëruar me aktin nr. 1301/3 prot., datë 03.07.2018.
4. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist Urbanist*”, emëruar me aktin nr. 2237 prot., datë 29.12.2017.
5. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i Pyjeve, Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjor dhe Kontrollit Ushqimor*”, emëruar me aktin nr. 743/3 prot., datë 23.04.2018.
6. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i Shërbimit Veterinar*”, emëruar me aktin nr. 744/3 prot., datë 23.04.2018.
7. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist IT*”, emëruar me aktin nr. 1300/3, datë 03.07.2016.
8. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i Trashëgimisë Kulturore*”, emëruar me aktin nr. 1344/1 prot., datë 06.07.2018.
9. ***** , është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist Auditi*”, emëruar me aktin nr.636/3 prot., datë 12.04.2018.

Përpozicionet: “*Përgjegjës i Shërbimit Social*”, “*Përgjegjës i Sektorit të Biznesit*”, “*Drejtor i Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit*” dhe “*Drejtor i Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjor dhe Kontrollit Ushqimor*”, plotësimi i vendeve vakante është bërë në përputhje me nenin 26, pika e 4, e ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që parashikon se, përjashtimisht, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët e të mesme drejtuese, mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira, por në çdo rast, pa kaluar kufirin prej 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik. Në përfundim të kësaj procedure, kanë rezultuar fitues dhe janë emëruar punonjësit e mëposhtëm:

1. ***** , është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjëse e Shërbimit Social*”, emëruar me aktin nr. 745/3 prot., datë 23.04.2018,
2. ***** , është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Biznesit*”, emëruar me aktin nr. 2203/3 prot, datë 29.12.2017.

3. *****, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor i Planifikimit Urban dhe Kontrollit të Zhvillimit*”, emëruar me aktin nr.2176/3 prot., datë 27.12.2017.
4. *****, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor i Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjor dhe Kontrollit Ushqimor*”, emëruar me aktin nr. 2205/3, prot., datë 03.07.2018.

Punonjësi *****, është emëruar në pozicionin Punonjës Mirëmbajtës, Njësia Administrative Ruzhdie, emëruar me aktin nr. 1509 prot., datë 02.07.2018, pozicion pune jashtë fushës së veprimit të ligjit nr. 152/2013.

Në lidhje me pikën 3 të vendimit paralajmërues është lënë detyrë që pozicionet e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve*”, “*Specialist Urbanist*”, “*Specialist Projektesh*”, “*Specialist Auditi*”, “*Specialist Jurist*”, “*Specialist i Administrimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Zhvillimit të Bujqësisë dhe të Ardhurave Vendore*”, si dhe dy pozicione pune “*Specialist Shërbimesh*” dhe “*Specialist Topograf*”, të shpallen të lira dhe të vijojnë procedurat e rekrutimit në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil dhe në koherencë me strukturën dhe nevojat aktuale të institucionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që materializon procedurat e rekrutimit, vërej se, pozicionet e evidentuara në pikën 3 të vendimit të paralajmërimit të Komisionerit, janë shpallur të lira dhe ka vijuar procedura e rekrutimit në përputhje me ligjin për shërbimin civil.

Në lidhje me pikën 4 dhe pikën 5 të vendimit paralajmërues, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës dhe vlerësimeve për të gjitha pozicionet e shërbimit civil në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji.

Konstatoj se njësia përgjegjëse në bashkëpunim me subjektet e tjera të ngarkuara nga ligji kanë kryer veprimet për hartimin e përshkrimeve të punës dhe vlerësimeve për çdo pozicion pune të shërbimit civil.

Në lidhje me pikën 6 të vendimit paralajmërues, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të plotësojë dosjet e personelit me të gjitha dokumentet e konstatuara në mungesë sipas aneksit bashkëlidhur raportit përfundimtar.

Bazuar në përmbajtjen e Aktit të Konstatimit, vërej se, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Patos ka plotësuar të gjitha dosjet e nëpunësve sipas Lidhjes 1 dhe 2 bashkëlidhur Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Duke vlerësuar punën e njësisë përgjegjëse në këtë institucion, si dhe nga gjithë sa u analizua më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të administruar gjatë procesit të verifikimit, arrij në konkluzionin se nga ana e institucionit janë zbatuar drejt detyrimet e lëna në vendimin paralajmërues të Komisionerit dhe janë realizuar plotësisht ato.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 39, datë 27.04.2018, *"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Patos dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit të Bashkisë Patos, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit paralajmërues të Komisionerit Nr.39, datë 27.04.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Patos.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha